



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 764/4 Prot

Tiranë, më 01/10.2015

V E N D I M

Nr. 37, datë 01/10 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Sophie Caffè" Tiranë,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.168 datë 04.09.2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Sophie Caffè", me NIPT: L41802034M, dhe emër tregëtar Marenglen Skëndi, me objekt:

- *Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme" i ndryshuar.*
- *Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.*

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Nga kontrolluesi "Sophie Caffè", është shkelur neni 21 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, sipas të cilit:

"1-Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë."

Kontrolluesi “Sophie Caffè”, nuk ka njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit, në kohën e duhur për grumbullimin, mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave “imazhe” të subjekteve të të dhënave personale, njoftim i cili është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave të subjekteve (klientë).

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverballi i kontrollit administrativ, datë 07.09.2015, si dhe në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 23.09.2015 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ. Në këtë seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i kontrolluesit dhe u administruan pretendimet me shkrim.

Në këto pretendime kontrolluesi pranon që gjetjet e grupit të kontrollit janë të sakta, nuk kundërshton faktin që shkeljet janë kryer, si dhe raporton për marrjen e masave lidhur me plotësimin detyrimeve ligjore të konstatuara nga kontrolli administrativ i kryer pranë tyre. Kontrolluesi ka vlerësuar këtë kontroll dhe ka marrë masa konkrete për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Si përfundim konkludoj se, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbën “**kundërvajtje administrative**” dhe sanksionohet me gjobë.

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, pasi lidhet, me sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me detyrimet që i dalin kontrolluesit nga zbatueshmëria e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neni 39/1, në të cilin parashikohet se: “Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë...etj”, faktin që kontrolluesi ka qenë serioz dhe bashkëpunues gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ dhe ka marrë masa për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 29, 30, 32, 39/1, paragrafi “b”, 39/1, paragrafi “d”, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit “Sophie Caffè”, me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 21** të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30(tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 40 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të dhënave personale*" (i ndryshuar).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

